



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government



Ministria e Mbrojtjes
Ministarstvo Odbrane / Ministry of Defense

Drejtoria e Burimeve Njerëzore/Direktorat Ljudskih Resurs/Human Resources Directorate

Duke marrë parasysh nenin 5, paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 dhe nenin 35 paragrafi 3 i Rregullores Nr. 07/2023 për Rekrutim në FSK, nenin 17 të Rregullores Nr. 12/2023 për Zhvillimin e Karrierës së Pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës, si dhe duke pasur për bazë ofertën nga Republika Turqisë, Ministria e Mbrojtjes shpall:

K O N K U R S I B R E N D S H Ë M
Për përzgjedhjen e kandidatëve të cilët do të ndjekin programin në Republikën e Turqisë;

„Trajnimi i Nënoficerëve për kalim në Oficer”

Dy (2) kandidatë

PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE PËRZGJEDHJES

Kandidati që aplikon për në ‘Trajnimi i Nënoficerëve për kalim në Oficer’ në Republikën e Turqisë duhet:

- Të jetë pjesëtar aktiv i FSK-së;
- Në ditën e mbylljes së konkursit të mos jetë më i vjetër se 36 vjeç;
- Të ketë përfunduar studimet universitare civile (niveli bachelor);
- Të mos ketë shkelje disiplinore dhe të mos jetë në procedurë për shkelje disiplinore;
- Të jetë me gradë Rreshter (OR5), Rreshter Shtabor (OR6) apo Rreshter i Klasit të Parë (OR7);
- Të ketë njohuri të gjuhës turke sipas nivelit të kërkuar të pozitës;

Shënim; Bazuar në ofertën nga Pala Turke dhe kriteret për shkollim nga NOF në OF në Republikën e Turqisë, kandidatët duhet të kenë njohuri të gjuhës Turke, për shkak se shkollimi mbahet në gjuhën turke.

Kandidatët e përzgjedhur pas përfundimit me sukses të programit ‘Trajnimi i Nënoficerëve për kalim në Oficer’, gradohen në gradën e Nëntogerit të FSK-së. Kandidatët, të cilët nuk e përfundojnë me sukses programin ‘Trajnimi i Nënoficerëve për kalim në Oficer’, kthehen në pozitë të mëparshme ose në pozitë të lira të barasvlershme me gradën e tyre paraprake.

Testet që aplikohen:

- Testi fizik;
- Intervista/Testi i gjuhës turke (pala pritëse);
- Testin e inteligjencës dhe të njohurive të përgjithshme;
- Intervista;
- Ekzaminimin shëndetësor.

Shënim: Kalimi me sukses i testit paraprak është kusht për të drejtën e testimit në fazën vijuese.

E drejta në ankesë

- Të drejtën e ankesës e ka çdo kandidatë pas marrjes së rezultateve të çdo faze të testimit përkatës.
- Rezultatet publikohet në Web-faqen e Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së dhe kandidatët e eliminuar kanë të drejtë ankesë brenda afatit dy (2)- ditor.
- Afati i ankesës rrjedh ditën pasuese pas publikimit të rezultatit.
- Ankesa dorëzohet përmes e-mail adresës së Rekrutimit.
- E drejta e ankesës aplikohet për të gjitha llojet e testimeve.

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Diploma universitare (bachelor),
- Ekstrakti i lindjes (jo më të vjetër së gjashtë (6) muaj);
- Certifikata nga gjykata që nuk është i dënuar dhe që nuk është nën hetime (dokumenti të jetë i nxjerrur brenda afatit të konkursit);
- Kopje e pasaportës;
- Foto portret 4x4 për aplikim (elektronike);
- Dëshmi për kualifikime tjera (nëse posedon);
- Dokumenti i zotësisë së veprimit.

KUSHTET TJERA:

- Pjesëtarët e FSK-së të cilët përzgjidhen ne programe tjera trajnimit, ruajnë të drejtën e kompensimit dhe pagën sipas gradës së tyre në momentin e aplikimit deri në përfundimin e programeve të trajnimit.
- Përzgjedhja është e kushtëzuar me kalimin e suksesshëm të procesit të verifikimit të pastërtisë së figurës.

Afati i konkurrimit;

- Konkursi i rekrutimit do të jetë i hapur prej **15.08.2025** deri më **22.08.2025**, ora 23:59.

Si të aplikoni;

Aplikimi dhe njoftimi për përzgjedhjen e kandidateve është online në adresën <https://rekrutimi.fsk-rks.org/Apply> si dhe njoftimi për shpalljen e konkursit munde ta shikoni edhe në web faqen e MM-së, <https://mod.rks-gov.net>, ku gjendet shpallja e konkursit. **Kandidatët plotësojnë formularin e aplikimit online <https://rekrutimi.fsk-rks.org/Apply> dhe bashkëngjisin të gjitha dokumentet tjera të kërkuara nga ky formular.** Kandidatët kanë të drejtë të aplikojnë deri në ditën e fundit të përmbylljes së konkursit. Për informata plotësuese, mund të kontaktoni në nr. Tel.038- 555584 dhe 038- 551930, 049 906 930 nga ora 09:00 deri 15:00.

Ministria e Mbrojtjes dhe FSK-ja ofron trajtim të barabartë për të gjithë pjesëtarët e FSK-së dhe mirëpret aplikacionet e tyre, pa dallim nga përkatësia etnike apo gjinore sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara në këtë konkurs